- (a) Nëse ka ndonjë mospërputhje midis çmimit për njësi dhe çmimit total, që rezulton nga shumëzimi i çmimit të njësisë me sasinë, çmimi i njësisë mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij. Në këtë rast, do të korrigjohet edhe shuma në fjalë, e cila ka lidhje me gabimin.
- (b) Nëse ka ndonjë mospërputhje tek çmimi total, kur totali është shuma ose diferenca e nëntotaleve, çmimi i nëntotalit mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij. Në këtë rast, do të korrigjohet edhe shuma në fjalë, e cila ka lidhje me gabimin.
- (c) Nëse ka ndonjë mospërputhje ndërmjet shumës në fjalë dhe shumës në shifra, mbizotëron shuma në fjalë. Bën përjashtim nga ky rregull situata kur, shuma në fjalë ka mospërputhje me shumën në shifra, ndërkohë që kjo e fundit nuk ka gabime aritmetike në përlllogaritjen e zërave të ofertës.

Në çdo rast, Ofertat me gabime aritmetike refuzohen kur:

- shumat absolute të të gjitha korrigjimeve janë më shumë se 2% e

vlerës së ofertës ekonomike të ofruar;

- shuma absolute e të gjitha korigjimeve është më pak se 2%, por nuk pranohet korigjimi nga ofertuesi.

2. Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% të fondit limit të përlogaritur.

Në rast kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.

Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave i refuzon ato, duke i skualifikuar nga procedura, pa i kërkuar sqarim ofertuesit/sve.

Në procedurat e prokurimit me vlerë mbi kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhet ti kërkojë operatorit ekonomik të paraqesë brenda tre ditëve pune, shpjegime të çmimit ose kostove të propozuara në ofertë, në përputhje me nenin 93 të LPP-së dhe të vlerësojnë informacionin e dhënë, në konsultim me ofertuesin, në përputhje me dispozitat e këtij neni.

Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të justifikojë dhe dokumentojë me prova me shkrim, shpjegime për elementin/elementët specifike të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93 të LPP-së.

2.1 Formula që duhet zbatuar, për të vlerësuar një ofertë anomalisht të ulët, në rastin kur ekzistojnë tre ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë:

O - Oferta

MO – Mesatarja e ofertave të vlefshme

N - Numri i ofertave të vlefshme

PR (Zm) – Zbritje e mundshme

$$MO = O1 + O2 + O3 + \dots On / N$$

$$PR = 85 \% Mo$$

Vlera e ofertave të vlerësuara < .. PR rrjedhimisht oferta është anomalisht e ulët.

3. Nëse një Operator Ekonomik nuk pranon korigjimin e gabimeve aritmetike, ose nëse Ofertuesi nuk arrin të japë një justifikim për të bindur Autoritetin/Entin Kontraktor, në rast të një oferte anomalisht të ulët, Oferta e tij do të refuzohet.

4. Procesi i hedhjes se shortit

Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë të njëjtat pikë, atëherë fituesi përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Ofertuesit njoftohen për datën dhe kohën e hedhjes së shortit. Mospjesëmarrja e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën arsye për skualifikim.

D. DHËNIA E KONTRATËS

23. Njoftimi i Fituesit

1. Brenda afatit të vlefshmërisë së Ofertës, Autoriteti/Enti Kontraktor njofton Operatorin Ekonomik të suksesshëm se, Oferta e tij është pranuar, dhe është shpallur fituese.

24. Nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër/ Kontratës

1. Pas konfirmimit të fituesit/ve Autoriteti/Enti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen kuadër/Kontratën.
2. Autoriteti/Enti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, dorëzohet para nënshkrimit të Kontratës.

Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:

- a) mundësi pagese nga ofertuesi në vlerë monetare, në llogarinë e autoritetit ose entit kontraktor;
- b) garanci bankare
- c) garanci nga shoqëri sigurimi.

DH. ANKESAT

25. Procedura e ankesës

1. Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes të ligjshëm për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit/entit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore, në Sistemin e Ankesave Elektronike.
2. Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit ose entit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Kundër vendimit të autoritetit ose entit kontraktor, operatorët

ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

3. Autoriteti/Enti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

E. ANULIMI I PROCEDURËS

26. Anulimi i procedurës

1. Autoriteti / Enti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.
2. Autoriteti/ enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:
 - a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë e përshtatshme në procedurat me faza;
 - b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
 - c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
 - d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor ka ndryshuar;
 - e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021, të ndryshuar.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti/ enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.
4. Nëse, Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të rishpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna, nuk duhet të vijojë me rishpalljen e saj në Sistemin e Prokurimit Elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

SEKSIONI II:LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1: Formulari i Ofertës Ekonomike

Shtojca 2: Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit

Shtojca 3: Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4: Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 5: Deklaratë mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Shtojca 6: Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 7: Formulari i Shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit

Shtojca 8: Formulari i Termave të Referencës

Shtojca 9: Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 10: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të skualifikimit

Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Fituesit, në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit.

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, në përfundim të afateve të ankimit.

Shtojca 16: Formulari i Njoftimit të Anulimit të Procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE³

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi -të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë të kryejmë për Autoritetin/Entin Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:
1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 2. Njoftimin e Kontratës;
 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 4. Specifikimet teknike, grafikun e ekzekutimit dhe termat e referencës;
 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
 7. Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.
- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

³ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore

Shtojca 2.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ELEMENTËVE PËRBËRËS TË SHËRBIMIT

Data: _____

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë
(në rast BOE): _____

Monedha: _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë elementëve përbërës të ofertës ekonomike duhet t'u vendoset çmimi i ofruar në këtë Listë, pasi elementët e Ofertës Ekonomike pa vlerë do të konsiderohen si shërbime të paofruara dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

1	2	3	4	6	
Nr.	Përshkrimi i elementëve të përbërës të Ofertës Ekonomike	Njesia	Sasia	Çmimi për njësi	Çmimi total (3 x 4X)
1	Shërbim-Mirëmbajtje të programit (softuerit) për kryerjen e tarimeve, koordinimit dhe selektivitetit të mbrojtjes rele si dhe analizës së flukseve të fuqisë për rrjetin e transmetimit	Vite	2		
Çmimi total					_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					
Nënshkrimi					
Vula					
Datë _____					

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit/entit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kerkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.
like ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

(⁴Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik)

DEKLARATË

Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Deklaratë për procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti/Enti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____, në cilësinë e anëtarit të stafit të operatorit ekonomik “.....” për procedurën e prokurimit me objekt _____ nën përgjegjësinë time personale, **Deklaroj** se:

1. Autorizoj VETËM operatorin ekonomik “.....” të paraqesë personin tim dhe të gjithë dokumentacion e nevojshëm, si anëtar i stafit të tij në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti/Enti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Deklarimi i personit tim, si anëtar i stafit nga ana e çdo operatori ekonomik tjetër, për procedurën e prokurimit me objektështë i pamiratuar dhe pa pëlqimin e personit tim.

2. Jam i disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula

⁴ Kjo Shtojcë do të paraqitet në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme.

Shtojca 6.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikimet Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për eficientësinë e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;

b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit;

c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT**Shërbimi që kërkohet:**

“Shërbim-Mirëmbajtje të programit (softuerit) për kryerjen e tarimeve, koordinimit dhe selektivitetit të mbrojtjes rele si dhe analizës së flukseve të fuqisë për rrjetin e transmetimit”, sipas Termave të References.

Afatet e ekzekutimit: 24 (njëzet e katër) muaj nga hyrja ne fuqi e kontratës.

1	Shërbim-Mirëmbajtje të programit (softuerit) për kryerjen e tarimeve, koordinimit dhe selektivitetit të mbrojtjes rele si dhe analizës së flukseve të fuqisë për rrjetin e transmetimit			24 (njëzet e katër) muaj nga hyrja ne fuqi e kontratës, sipas Termave të References
---	---	--	--	---

Shtojca 8.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS

PËRMBAJTJA

1. <u>TË PËRGJITHSHME</u>	24
2. <u>HYRJE DHE SFONDI KRYESOR</u>	24
3. <u>SPECIFIKIMET TEKNIKE</u>	27
3.1 <u>Objektivat</u>	27
3.2 <u>Shërbimet e kërkuara</u>	27
3.2.1 <u>Instalimi dhe Konfigurimi</u>	27
3.2.2 <u>Mirëmbajtja dhe Përditësimet</u>	27
3.2.3 <u>Mbështetja Teknike</u>	27
3.2.4 <u>Standardet dhe Pajtueshmëria</u>	28
3.2.5 <u>Raportimi dhe Dokumentimi</u>	28
4. <u>MONITORIMI I PERFORMANCËS SË SHËRBIMEVE TË MIRËMBAJTJES SË SOFTUERIT ASPEN</u>	28
4.1 <u>Treguesit kryesorë të performancës (KPI)</u>	28
4.2 <u>Raportimi i rregullt</u>	29
4.3 <u>Menaxhimi i Incidentit</u>	29
5. <u>FREKUENCA E RAPORTIMIT PËR SHËRBIMET E MIRËMBAJTJES SË SOFTUREVE ASPEN</u>	29
5.1 <u>Raportet mujore të performancës</u>	29
5.2 <u>Takimet e rishikimit tremujor</u>	29
5.3 <u>Rishikimi Vjetor i Performancës</u>	29
5.4 <u>Raportet Ad-Hoc</u>	30
6. <u>AFATI DHE KUSHTET E KONTRATËS</u>	30
7. <u>SHËRBIMI QË DO TË OFROHET</u>	30
8. <u>REFERENCAT</u>	31
☐ <u>FAQJA ZYRTARE E ASPEN</u>	31
☐ <u>DOKUMENTE OSE MATERIALE TE ENTISO-E</u>	31

TË PËRGJITHSHME

Mbrojtja e rrjetit është elementi kyç për të zbutur rreziqet në një sistem energjie të ndërlidhur dhe për të rritur besueshmërinë e furnizimit me energji elektrike duke kontribuar në elasticitetin e vetë sistemit. Modelimi i duhur i pajisjeve mbrojtëse është një detyrë thelbësore për inxhinierin e sistemit elektroenergjetik.

Rrjeti i transmetimit i Shqipërisë funksionon duke ruajtur dhe përmirësuar vazhdimisht performancën e tij, veçanërisht në drejtim të sigurisë dhe cilësisë së furnizimit për të gjithë klientët e tij. Mbetet detyrë e përhershme e operatorit të këtij Sistemi të planifikojë dhe zbatojë masa në terma të ndryshëm kohorë, për të përmirësuar gjendjen e tij drejt ruajtjes dhe arritjes së mëtejshme të standardeve.

Referuar Ligjit nr.43/2015 “Për Sektorin e Energjise Elektrike” dhe Kodit të Transmetimit, Operatori i Sistemit të Transmetimit kryen planifikimin e sistemit të Transmetimit për zhvillimin e Sistemit të Transmetimit dhe operimin e sigurtë duke respektuar standartet e sigurisë. Studimet e Sistemit të Transmetimit kryhen në rrafsh kohorë të ndryshme, duke filluar nga planifikimi për ditën në avancë (D-1), javën në avancë (Ë-1), muajin në avancë (M-1), vitin në avancë (Y-1), 5 vite në avancë (Y-5), 10 vite në avancë (Y-10).

Studimet për planifikimin e sistemit kryhen nga specialiste/inxhinier me eksperience në sistemin e transmetimit me njohuri të thelluara mbi funksionimin e sistemit elektroenergjetik.

Studimi dhe Planifikimi i sistemit elektroenergjetik realizohet duke përdorur softere inxhinierike duke shfrytëzuar modelimin matematikor të rrjetit të transmetimit (linja, nenstacione, transformator, ngarkesa, gjenerator, elemente kompensues, etj).

Gjithashtu, OST është anëtare me të drejta të plota në ENTSO-E (Shoqata Evropiane për Bashkëpunimin e Operatorëve të Sistemit të Transmetimit (OSTve) për Energjinë Elektrike), që nga viti 2017 dhe ka detyrimin të përmbushë rregullat dhe standartet që përmban kjo organizatë dhe harmonizimin e kuadrit ligjor të Bashkimit Europian në fushën e energjisë.

HYRJE DHE SFONDI KRYESOR

OST është përgjegjëse për instalimin e mbrojtjes rele në të gjithë Rrjetin e Sistemit të Transmetimit 400 kV, 220 kV, 150 kV dhe 110 kV. OST miraton sistemin e mbrojtjes rele dhe vendos cilësimet në elementët e rrjetit në koordinim me përdoruesit e rrjetit të transmetimit.

Për qëllime të përcaktimit të tarimeve dhe analizës së koordinimit dhe selektivitetit të mbrojtjes rele në sistemin e transmetimit, OST ka në përdorimin e saj programet:

- ASPEN ASPEN OneLiner,
- ASPEN Power Flow dhe
- ASPEN Relay Database

Programet ASPEN OneLiner, ASPEN Power Flow dhe ASPEN Relay Database janë mjete të fuqishme softuerike të përdorura për analizën dhe menaxhimin e rrjeteve të energjisë elektrike dhe që ndihmojnë në

kryerjen e tarimeve, koordinimit dhe selektivitetit të mbrojtjes rele, si dhe analizës së flukseve të fuqisë për rrjetet e transmetimit por dhe të shpërndarjes së energjisë elektrike. Përdorimi i këtyre programeve ndihmon në përmirësimin e besueshmërisë, efikasitetit dhe performancës së rrjetit, duke siguruar një furnizim të qëndrueshëm dhe të besueshëm me energji elektrike.

Shkurtimisht funksionet kryesore të këtyre programeve renditen si vijon:

► I. ASPEN OneLiner

Përshkrimi

ASPEN OneLiner është një program i koordinimit të lidhjeve të shkurtra dhe tarimeve të mbrojtjes re i bazuar në PC (kompjuter personal). Ai thjeshton procesin e analizimit dhe koordinimit të cilësimeve të tarimeve, duke e bërë atë një mjet të vlefshëm për të garantuar besueshmërinë dhe sigurinë e rrjeteve elektrike.

Karakteristikat Kryesore

Analiza e Tarimeve: Kryen analiza të detajuara të tarimeve për të identifikuar dhe korrigjuar problemet në rrjet.

- **Koordinimi i Mbrojtjes Rele:** Ndihmon në koordinimin e mbrojtjes rele për të siguruar selektivitetin dhe besueshmërinë e sistemit.
- **Simulimi i Defekteve:** Lejon simulimin e defekteve për të vlerësuar performancën e mbrojtjes rele.
- **Raportimi i Detajuar:** Gjeneron raporte të detajuara për analizat e kryera, duke përfshirë të dhënat e tarimeve dhe mbrojtjes rele.

Përdorimet

- **Tarimet e Rrjetit:** Identifikimi dhe korrigjimi i problemeve të tarimeve në rrjetet e shpërndarjes dhe transmetimit.
- **Koordinimi i Mbrojtjes:** Sigurimi i selektivitetit dhe besueshmërisë së mbrojtjes rele në rrjetet elektrike.
- **Simulimi i Defekteve:** Vlerësimi i performancës së mbrojtjes rele përmes simulimeve të defekteve.

► II. ASPEN Power Flow

Përshkrimi

ASPEN Power Flow është një program i avancuar për analizën e flukseve të fuqisë në rrjetet elektrike. Ai përdoret për të kryer studime të stabilitetit të tensionit dhe për të optimizuar operacionet e rrjetit.

Karakteristikat Kryesore

- **Analiza e Flukseve të Fuqisë:** Kryen analiza të detajuara të flukseve të fuqisë për të identifikuar dhe korrigjuar problemet në rrjet.
- **Studimet e Stabilitetit të Tensionit:** Ndihmon në kryerjen e studimeve të stabilitetit të tensionit për të siguruar funksionimin e qëndrueshëm të rrjetit.
- **Optimizimi i Operacioneve:** Lejon optimizimin e operacioneve të rrjetit për të përmirësuar efikasitetin dhe besueshmërinë.
- **Raportimi i Detajuar:** Gjeneron raporte të detajuara për analizat e kryera, duke përfshirë të dhënat e flukseve të fuqisë dhe stabilitetit të tensionit.

Përdorimet

- **Analiza e Flukseve të Fuqisë:** Identifikimi dhe korrigjimi i problemeve të flukseve të fuqisë në rrjetet elektrike.
- **Studimet e Stabilitetit:** Kryerja e studimeve të stabilitetit të tensionit për të siguruar funksionimin e qëndrueshëm të rrjetit.
- **Optimizimi i Operacioneve:** Përmirësimi i efikasitetit dhe besueshmërisë së operacioneve të rrjetit.

► ASPEN Relay Database

Përshkrimi

ASPEN Relay Database është një program për menaxhimin e të dhënave të mbrojtjes rele dhe analizën e performancës së tyre. Ai ndihmon në organizimin dhe analizimin e të dhënave të mbrojtjes rele për të siguruar funksionimin optimal të sistemit të mbrojtjes.

Karakteristikat Kryesore

- **Menaxhimi i të Dhënave:** Lejon menaxhimin e të dhënave të mbrojtjes rele, duke përfshirë konfigurimet dhe parametrat e mbrojtjes.
- **Analiza e Performancës:** Kryen analiza të performancës së mbrojtjes rele për të identifikuar dhe korrigjuar problemet.
- **Raportimi i Detajuar:** Gjeneron raporte të detajuara për analizat e kryera, duke përfshirë të dhënat e performancës së mbrojtjes rele.
- **Integrimi me Sistemet e Tjera:** Lejon integrimin me sistemet e tjera të menaxhimit të rrjetit dhe bazat e të dhënave.

Përdorimet

- **Menaxhimi i të Dhënave të Mbrojtjes:** Organizimi dhe menaxhimi i të dhënave të mbrojtjes rele për të siguruar funksionimin optimal të sistemit të mbrojtjes.
- **Analiza e Performancës:** Vlerësimi i performancës së mbrojtjes rele përmes analizave të detajuara.
- **Raportimi dhe Dokumentimi:** Gjenerimi i raporteve të detajuara për analizat e kryera dhe dokumentimi i të dhënave të mbrojtjes rele.
- Përfitimet e Përdorimit të Programeve ASPEN
- **Përmirësimi i Besueshmërisë:** Sigurimi i funksionimit të qëndrueshëm dhe të besueshëm të rrjetit të energjisë elektrike.
- **Optimizimi i Operacioneve:** Përmirësimi i efikasitetit dhe performancës së operacioneve të rrjetit.
- **Reduktimi i Rreziqeve:** Identifikimi dhe korrigjimi i problemeve potenciale për të reduktuar rreziqet e defekteve dhe ndërprerjeve.
- **Përputhshmëria me Standardet:** Sigurimi i përputhshmërisë me standardet dhe rregulloret ndërkombëtare për menaxhimin e rrjeteve të energjisë elektrike.
- Përputhshmëria e softuerit me programet e tjera dhe gjuha e programimit të tij
- Importimi i të dhënave për të dhënat e rrjetit në CIM, ANAFAS, ANAREDE, GE, PTI PSS/E, T2000 dhe formate të tjera.

-
- Eksportimi i të dhënave në formatet e të dhënave CIM, PTI PSS/E, ANAFAS, ANAREDE dhe GE.
 - Eksportimi i të dhënave të defekteve për testimin e releve në COMTRADE, Doble dhe formate të tjera.
 - Mjet i integruar i skriptimit me ndërfaqen e gjuhës së programimit BASIC.
 - Moduli i ndërfaqes së programimit të aplikacionit me mbështetje për Python, C++, C# dhe mundësisht për gjuhë të tjera programimi
 - Numri i Licensave
 - **Numri i licensave për këtë softuer është 3 (tre).**
 - **Softueri funksionon në çdo kompjuter desktop ose laptop që ka akses të çelësi i licencës ose lokalisht në portën USB të makinës (dongle) ose përmes rrjetit në një makineri të dedikuar të serverit të licencës (çelësi i rrjetit).**

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Këto specifikime teknike përshkruajnë kërkesat minimale për ofrimin e shërbim-mirëmbajtjes për programet ASPEN OneLiner, ASPEN Power Flow dhe ASPEN Relay Database, të cilat përdoren për kryerjen e tarimeve, koordinimit dhe selektivitetit të mbrojtjes rele, si dhe analizës së flukseve të fuqisë për rrjetin e transmetimit në Shqipëri.

Objektivat

- Sigurimi i funksionimit të pandërprerë dhe të qëndrueshëm të programeve ASPEN.
- Përmirësimi i performancës dhe efikasitetit të analizave të rrjetit të transmetimit.
- Sigurimi i përputhshmërisë me standardet dhe rregulloret ndërkombëtare.
- Trajnimi i personelit për përdorimin efektiv të programeve ASPEN.

Shërbimet e kërkuara

Instalimi dhe Konfigurimi

- Instalimi i programeve ASPEN OneLiner, ASPEN Power Flow dhe ASPEN Relay Database në serverët dhe kompjuterët e OST-së.
- Konfigurimi i programeve sipas kërkesave specifike të rrjetit të transmetimit të Shqipërisë.
- Integrimi me sistemet ekzistuese të menaxhimit të rrjetit dhe bazat e të dhënave.

Mirëmbajtja dhe Përditësimet

- Mirëmbajtja rutinë dhe përditësimi i programeve për të siguruar funksionimin optimal.
- Aplikimi i arnimeve të sigurisë dhe përditësimeve të versioneve të reja të programeve.
- Monitorimi i performancës së programeve dhe zgjidhja e problemeve teknike.
- Menaxhimin/Mirëmbajtjen e modeleve me të gjithë komponentet perberes te tij, versioneve te ndryshme etj;
- Mirembajtjen e modeleve gjate fazave te ndryshme te analizave, shtimin e elementeve te rinj etj;

Mbështetja Teknike

-
- Ofrimi i mbështetjes teknike 24/7 për zgjidhjen e çështjeve emergjente.
 - Asistenca teknike për përdoruesit gjatë përdorimit të programeve ASPEN.
 - Konsultimi për optimizimin e përdorimit të programeve dhe përmirësimin e proceseve të analizës.
 - Mbështetje teknike në rast dëmtimi license,
 - Konsultimi me telefon dhe email mbi përdorimin e Softuerit për punonjësit e të Licencuarit
 - Konvertimin në formatet e kërkuar nga ENTSO-E (CIM Profile, CGMES), si dhe të jetë kompatibël me formatet që përdoren;
 - Mbështetje për përditësimin e softeve One Linear, Power Flow dhe Relay Database me versionet e reja;
 - Mbështetje për validimin e modeleve pa ‘errore’ dhe ‘warning’ në baze të rulesetit (QoCDC) të vendosur nga ENTSO-E;
 - Mbështetje teknike në rast dëmtimi license,
 - Mbështetje teknike në rast keqfunksionimi të programeve, zëvendësimin brenda një periudhe 3 javore nëse vërtetohet që programi/programet është/janë i dëmtuar ose të dëmtuar dhe ka ose kanë defekte.
 - Mbështetje teknike në rast nevojë përditësimi në mënyrë që të jemi në pajtueshmëri me standartin e fundit të modeleve në formatin CGMES;
 - Mbështetje teknike për probleme të ndryshme.
 - Akses në forumet online.

Standardet dhe Pajtueshmëria

- Përputhshmëria me standardet ndërkombëtare të sigurisë dhe performancës (IEC, IEEE etj).
- Respektimi i rregulloreve kombëtare dhe ndërkombëtare për menaxhimin e rrjeteve të energjisë elektrike.

Raportimi dhe Dokumentimi

- Përgatitja e raporteve të rregullta për performancën dhe mirëmbajtjen e programeve ASPEN.
- Dokumentimi i të gjitha aktiviteteve të mirëmbajtjes dhe përditësimeve të kryera.
- Mbajtja e regjistrave të detajuar për të gjitha ndërhyrjet teknike dhe asistencën e ofruar.

MONITORIMI I PERFORMANCËS SË SHËRBIMEVE TË MIRËMBAJTJES SË SOFTUERIT ASPEN

Për të siguruar monitorimin efektiv të performancës për shërbimet e mirëmbajtjes së softuerit ASPEN OneLiner, ASPEN Power Flow dhe ASPEN Relay Relay, strategjitë dhe matjet e mëposhtme do të zbatohen:

Treguesit kryesorë të performancës (KPI)

- *Koha e funksionimit të sistemit:* Matja e përqindjes së kohës që softueri është funksional dhe i disponueshëm për përdorim.
- *Koha e përgjigjes:* Ndjekja e kohës së nevojshme për t'iu përgjigjur kërkesave të mbështetjes teknike.
- *Koha e Rezolucionit:* Monitorimi i kohës së marrë për të zgjidhur çështjet dhe për të rivendosur funksionimin normal.

- *Frekuenca e përditësimit:* Regjistrimi i frekuencës së përditësimeve të softuerit dhe arnimeve të aplikuara.
- *Kënaqësia e përdoruesit:* Mblidhja e komente nga përdoruesit në lidhje me kënaqësinë e tyre me softuerin dhe shërbimet mbështetëse.

Raportimi i rregullt

- *Raportet mujore të performancës:* Gjenerimi i raporteve mbi performancën e sistemit, duke përfshirë kohën e funksionimit, kohën e përgjigjes dhe statistikën e zgjidhjes së çështjeve.
- *Takimet e rishikimit tremujor:* Kryerja e takimeve me përdoruesit për të rishikuar raportet e performancës, për të diskutuar çdo çështje dhe për të planifikuar përmirësime.
- *Rishikimi vjetor i performancës:* Vlerësimi i performancës së përgjithshme të shërbimeve të mirëmbajtjes së programeve gjatë vitit dhe vendosja e synimeve për vitin e ardhshëm.

Menaxhimi i Incidentit

- *Ndjekja e incidentit:* Mbajtja e një regjistri të të gjitha incidenteve, duke përfshirë detajet e çështjes, kohën e përgjigjes, kohën e zgjidhjes dhe çdo veprim pasues.
- *Analiza e shkakut rrënjësor:* Kryerja e analizës së shkakut rrënjësor për çështjet e përsëritura për të identifikuar dhe trajtuar problemet themelore.

FREKUENCA E RAPORTIMIT PËR SHËRBIMET E MIRËMBAJTJES SË SOFTUREVE ASPEN

Për të siguruar monitorim gjithëpërfshirës dhe komunikim efektiv, do të zbatohet plani i mëposhtëm i raportimit:

Raportet mujore të performancës

- *Frekuenca:* Një herë në muaj
- *Përmbajtja:* Analizë e detajuar e performancës së sistemit, duke përfshirë kohën e funksionimit, kohën e përgjigjes, statistikën e zgjidhjes së problemeve dhe çdo incident që ka ndodhur gjatë muajit.
- *Qëllimi:* Për të siguruar një përditësim të rregullt mbi shëndetin dhe performancën e programeve ASPEN dhe për të identifikuar çdo çështje të përsëritur ose fusha për përmirësim.

Takimet e rishikimit tremujor

- *Frekuenca:* Një herë në tre muaj
- *Përmbajtja:* Përmbledhja e raporteve mujore, diskutimi i treguesve kyç të performancës (KPI), rishikimi i çdo çështjeje ose përditësimi të rëndësishëm dhe planifikimi për tremujorin e ardhshëm.
- *Qëllimi:* Të sigurohet që të gjithë aktorët të jenë të informuar për performancën e përgjithshme dhe të marrin vendime strategjike për tremujorin e ardhshëm.

Rishikimi Vjetor i Performancës

- *Frekuenca:* Një herë në vit
- *Përmbajtja:* Rishikim gjithëpërfshirës i performancës së të gjithë vitit, duke përfshirë tendencat, incidentet kryesore, përditësimet dhe shëndetin e përgjithshëm të sistemit. Ky raport do të përfshijë gjithashtu rezultatet e anketës së kënaqësisë së përdoruesve dhe kontrollet e pajtueshmërisë.

- **Qëllimi:** Të vlerësohet efektiviteti i shërbimeve të mirëmbajtjes gjatë vitit, të vendoset synimet për vitin e ardhshëm dhe të sigurohet përafrimi strategjik afatgjatë.

Raportet Ad-Hoc

- **Frekuenca:** Sipas nevojës
- **Përmbajtja:** Raporte specifike të krijuara në përgjigje të incidenteve, përditësimeve ose kërkesave të palëve të interesuara.
- **Qëllimi:** Për të adresuar çështje urgjente, për të ofruar analiza të detajuara mbi tema specifike, ose për t'iu përgjigjur kërkesave rregullatore ose të pajtueshmërisë.

AFATI DHE KUSHTET E KONTRATËS

- Kontrata për shërbim-mirëmbajtjen të jetë e vlefshme për një periudhë prej 2 (dy) vitesh.

Nr	Emërtimi	Njesia	Sasia
1	Mirëmbajtja për programet (softwaret) ASPEN One Linear, ASPEN Power Flow dhe ASPEN Relay Database për kryerjen e tarimeve, koordinimit dhe selektivitetit të mbrojtjes rele për rrjetin e transmetimit	Vite	2

- Kushtet e pagesës dhe termat e shërbimit të përcaktohen në marrëveshjen kontraktuale.

SHËRBIMI QË DO TË OFROHET

1	2	3	4	6	
Artikulli	Përshkrimi i shërbimeve	Njësia	Sasia	Çmimi për njësi	Çmimi total për shërbim (3 x 4X)
1	Mirëmbajtja për program (software) ASPEN One Linear, ASPEN Power Flow dhe ASPEN Relay Database për kryerjen e tarimeve, koordinimit & selektivitetit të mbrojtjes rele si dhe analizës së flukseve të fuqisë për rrjetin e transmetimit	Vite	2		
Çmimi total (Mallrat)					_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					
Nënshkrimi					
Vula					

REFERENCAT

- ALBANIAN TRANSMISSION CODE
(https://www.ere.gov.al/images/files/2022/05/04/Kodi_i_Transmetimit_Vendim_nr.63_2022.pdf)
- FAQJA ZYRTARE E ASPEN
 - (<https://www.aspeninc.com/web/software/oneliner>)
 - (<https://www.aspeninc.com/web/software/relay-database>)
 - [HTTPS://WWW.ASPENINC.COM/WEB/SOFTWARE/POWER-FLOW](https://www.aspeninc.com/web/software/power-flow)
- DOKUMENTE OSE MATERIALE TE ENTSO-E
 - [HTTPS://WWW.ENTSOE.EU/DOCUMENTS/SOC%20DOCUMENTS/BEST_PROTECTION_PRACTICES_FOR_HV_EHV_AC_TRANSMISSION_SYSTEM.PDF](https://www.entsoe.eu/Documents/SOC%20DOCUMENTS/BEST_PROTECTION_PRACTICES_FOR_HV_EHV_AC_TRANSMISSION_SYSTEM.PDF)
 - [HTTPS://WWW.ENTSOE.EU/FILEADMIN/USER_UPLOAD/ LIBRARY/PUBLICATIONS/ENTSOE/ RG SOC CE/120425 RG CE TOP 06.5 D.2 SPS REPORT 1 .PDF](https://www.entsoe.eu/fileadmin/user_upload/library/publications/entsoe/rg_soc_ce/120425_rg_ce_top_06.5_d.2_sps_report_1.pdf)
 - [HTTPS://WWW.ENTSOE.EU/TECHNOPEDIA/TECHSHEETS/ADAPTIVE-PROTECTION-TECHNOLOGY](https://www.entsoe.eu/technopedia/techsheets/adaptive-protection-technology)

Shenim:

- i. Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, në të gjithë rastet në kur dokumentet e tenderit përmendet “markë” përfshihet termi “ose ekuivalenti i tij/saj”.
- ii. Kudo ne Specifikiet Teknike ku është cituar standard nderkombetar, do të pranohet edhe cilësim ekuivalent nga një institut vendor.

Shtojca 9

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 10.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

- Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas Pikes 1 te kesaj shtojce.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 *Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatori ekonomik ofertues duhet të ketë xhiro minimale vjetore të realizuar, për periudhën e 3 (tre) viteve të fundit financiare, te paktën 25,000,000 (njetzet e pese milion) Leke.*

Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Si prove per plotesimin e ketij kriteri kualifikues, operatori ekonomik ofertues duhet te disponoje vertetim nga Administrata Tatimore ku te tregohet xhiroja vjetore per vitet e siperpermendura dhe kopje të certifikuara të balanceve ku të paktën në dy balance të fundit, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

2.3 Kapaciteti teknik:

-
- 2.3.1 *Operatori ekonomik ofertues duhet te kete realizuar gjate tri viteve te fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, kontrata te ngjashme ne nje vlere te pakten prej 10,000,000 (dhjete milion) Lekë pa TVSH.*

Lidhur me kete pike:

Kur OE ka realizuar kontrata me nje ent publik, kerkohen vërtetime të lëshuara nga ky i fundit, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Shenim: Lidhur me mirembajtjen e softit objekt prokurimi, kontrata te ngjashme do te konsiderohen mirembajtjet e softeve te ngjashme te integruara ose kompatibel me sisteme energjitike.

- 2.3.2 *Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese Autorizim prodhuesi ose distributori te autorizuar per programin (softin) objekt prokurimi. Autorizimi duhet te permbaje te dhena te plota te prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website kjo e nevojshme per Autoritetin Kontraktor ne rast verifikimi nga ana e tij.*

